

## AKT THEMELIMI

### I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

#### “ALPHA-BRIGHT”SHPK

Sot më datën 01.06.2022, unë ortakut themelues:

**Anest Ikonomi**, i biri i Stefan, i datëlindjes 13.04.1958, lindur në Fier dhe banues në lagjen “29 Nëntori” Rruga “Mihal Bego” Nd.1, h.6, ap.15, Fier, i njohur nga Karta e Identitetit Nr. 037903567 dhe nr. Personal ID: F80413065L

Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 date 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 ”Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit “,

Kam vendosur të themelojnë *Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar “ALPHA-BRIGHT “ Shpk*

#### *Neni 1.*

#### **EMERTIMI I SHOQERISE**

Shoqëria do të quhet “**ALPHA-BRIGHT” SHPK.**

#### *Neni 2*

#### **SELIA E SHOQERISE**

Selia e shoqërisë është në adresën lagjen “29 Nëntori”; Rruga “Mihal Bego” Nd.1, h.4, Fier. Shoqëria mund të hapë filial të tjera në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

#### *Neni 3*

#### **OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE**

*Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë :*

- Import, eksport, tregtimi me shumicë dhe pakicë të artikujve të ndryshëm, të të gjitha llojeve për ndriçimin e të gjithë automjeteve,.

#### *Neni 4*

#### **KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE**

Kapitali themeltar i shoqërisë “ **ALPHA-BRIGHT” SHPK** është 1,000,100(Njëmilionenjëqind)

lekë.

Ky kapital është i ndarë në 1 pjesë, e cila ka vlerë nominale 1,000,100(Njëmilionnjëqind).lekë

Kontributi i ortakut është i ndare si vijon:

**Ortaku themelues Anest Ikonomi: zotëron 1 kuot baraz me 100 % të kapitalit.**

Kontributi i ortakut të vetëm themelues depozitohet në njërën prej bankave të nivelit të dytë në Shqipëri dhe dokumenti i bankar i depozitimit mbetet si pjesë akteve të themelimit.

## *Neni 5*

### **KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe mbi 10 vjet.

### **ADMINISTRIMI I SHOQERISE**

Administrator i shoqërisë do të jetë z. **Anest Ikonomi**, i cili emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Një Administrator tjetër mund të emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakut të vetëm, që përfaqëson njëqindpërqind të pjesëve të kapitalit themeltar. Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryej të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë.

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve përshkelje të ligjeve, statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

## *Neni 7*

### **VENDIMET E ORTAKUT TE VETEM**

Ortaku i vetëm i cili zotëron njëqind për qind të kuotave merr vendime të cilat janë të vlefshme sipas pikes 3 të nenit 81 të ligjit “Për shoqëritë Tregtare”.

Të gjitha vendimet e marra nga ortakut i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

*Neni 8*

**NDARJA E FITIMEVE**

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar, të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën, si dhe duke i shtuar apo zbritur respektivisht humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

*Neni 9*

**LIKUIDIMI**

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj, operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregëtar shqipëtar.

*Neni 10*

**MOSMARREVESHJET**

Mosmarreveshjet zgjidhen me mirëkuptim, në rast të kundërt, ortaku themelues do ti drejtohet Gjykatës së Rrethit për zgjidhje.

***SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR***

**“ALPHA-BRIGHT ” SHPK**

**ORTAKU I VETEM**

**ANEST IKONOMI**

*ANEST IKONOMI*  
